

AISHE MUSTA ALIÇKAJ  
**DHIMBJE DHE MALL**  
POEZI

---

BOTIMET TOENA



AISHE MUSTA ALIÇKAJ

DHIMBJE DHE MALL

*poezi*

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2020

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktor: Shuaip Duka

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike: Edona Marku

Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-86-2

© Autorja

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

## SHPIRTI I ZHUBROSUR

Me një torbë ika  
Larg nga këto dete,  
Fusha, pllaja, male,  
Malli që nuk tretet.

Rruga mister, fëmijët për dore,  
Kujtime gri, mall dhe derte,  
Shpirti i copëtuar, fjolla bore,  
Shpresë e plagosur për një rreze jete.

Por tani po kthehem  
Dhe pa torbë fare,  
Te pragu i portës  
Driza e përralle.

Kujtimet e dertet  
Një dramë e shpërbërë,  
Bëjnë të panjohurin  
Mbrapa ç'kisha lënë.

Në rrugët e mia  
Udhëtare e harruar  
Dhe shpresë e nemitur  
Me mjegull rrethuar.

Shpirti i zhubrosur,  
Çjerrë e lebetitur,  
Një kufomë e gjallë  
Nga varri e ngritur.

## **PËRSE, PËRSE**

Përse në dheun tim  
Çdo horizont përvëlim  
Dhimbje mallkim?

Ka vdekur shpresa  
S'ka agim.

Ëndrra vajzash lart në yje,  
Larë me lot, mbetur në hije;  
Zemra nënash përvëlur,  
Në dritare me sy ngujuar,  
Shekuj, vite të hutuara.

Djalëria shqiptare  
Pika loti për dëshira.  
Kënga e dasmës, larg tretur,  
Klithmë e heshtur mbi rrëpira.

Të lutem, të lutem o Zot  
Ktheja shpresën vendit tim,  
Thaja ata lot...

## **NJË GRUA E VE**

Një grua e ve  
Qerpik i munduar,  
Nga loti i ngarkuar  
Djegur përvëlur.  
Mbi syrin pa gjumë  
Shpirti i gjymtuar,  
Dhimbje dhe zhgënjim  
Zemër e copëtuar.

Një grua e ve  
Me jetimë rrethuar,  
Në moshë të re  
Vegim i lotuar.

Një grua e ve  
Motër e qëndresës,  
Çjerr mjegullën e dendur,  
Nis valsën e shpresës,  
Në gjumë e duke rendur  
Lotin e kthen në vesë  
Dhe zjarrin e fikur  
Nis prapë ta ndezë.



## **DHIMBJA**

Dhimbjen dua ta shpërndaj,  
Po nuk gjej, kujt dhe ku,  
T'ia shpërndaj qiellit blu  
Apo do të mbetet këtu?

Brez pas brezi, dhimbja e shkretë,  
Ku s'e çuan s'e përplasën,  
Nëpër gurë, shkëmbinj e male,  
Në galaktikën e madhe.

Po, u thërrmua edhe guri  
Bast me mua sikur vuri,  
E dhimbja e lodhur shumë,  
Erdhi të çlodhej tek unë.

## ËNGJËLLI I KOHËS MODERNE

Mirëmëngjesi,  
Një engjëll më përshëndet.  
Një engjëll hyjnor.  
E unë, pa u përmbajtur  
Në krahët e tij fluturoj,  
Me engjëj spërkatur.

Si e marrë përqafova  
Këmbët e lartësisë,  
Mes një qielli pa re,  
Larg nga toka, nga dheu,  
Nga e keqja, nga beu;  
Atje ku veç engjëjt kanë fole.

Engjëlli i kohës moderne  
Kudo më çon,  
Shkencën, elektronikën, robotin më sqaron.

Iu luta engjëllit, të mos më zbresë në tokë,  
Në kazanin e intrigës, urrejtjes plot pabesi,  
Se dua, si linda, të vdes njeri.

## KUR TI MË PUTH NË BUZË

Kur ti më puth në buzë,  
Ato nuk më njomen si më parë.  
Më tmerron tharja e tyre si shkarpë,  
Edhe pse ti vazhdon e i puth prapë.

Ato dy buzë më parë  
Më ëmbëlsonin, drithëronin, eksitonin,  
Në çdo skutë, qelizë e vend.  
Tani më hidhërojnë,  
Janë të thara e krejt pa lëng.

Ato dy buzë dikur  
Bashkonin fuqishëm zemrat tona.  
Tani më vrasin, bezdisin deri në neveri.  
Ç'ka ndodhur me ty o njeri?

Mos vallë mbi to ke mbjellë zhavorr  
E ruli i pabesisë i shtyp si mizor?

## FUSTANI

Fustani me lule shumë  
Të përdridhet përmbi gjunjë,  
Shkurtoje pak më shumë,  
Të ta puth atë lëkurë.

Lëkura porsi mëndafshi  
I shkreti, zemra më plasi,  
Porsi e lyer nga gjalpi,  
Lërma dorën të rrëshqasi.

Të rrëshqasë, të rrëshqasë,  
Që dhe zemra të mos plasë,  
Lart e lart e sa më lart  
Ku shpirti bie rehat.

More fustani mëndafsh  
Më ndeze, më vure flakë,  
Fryj moj erë e ngrije lart,  
Mbase freskohem ndopak.

## **MBRETI ME FUKARANË**

Mbreti me fukaranë  
U takuan në një arë,  
Vendosën u bënë bashkë,  
U bënë bashkë e shokë.  
I thotë mbreti urtë e ngrohtë:  
“Pa dëgjo more argat,  
Do të jemi të barabartë,  
Bashkë do të vemi në punë,  
Do të flemë bashkë, do të pimë ujë,  
Do të mbulohemi me një gunë,  
Veç veglat do t’i ndaj unë,  
Unë do të punoj me shat  
Ti vetëm me lopatë”.

## MJERIMI I MIJËVJEÇARIT TË RI

Mjerim i mijëvjeçarit të ri  
Ti nuk shfaqesh si një kalimtar,  
I harruar, pa rëndësi,  
Por je shtruar, këmbëkryq,  
Oxhak më oxhak,  
Dhe kur bën ftohtë,  
Dhe kur bën vapë.

Mjerim i mijëvjeçarit të ri,  
Ti nuk je i ri.  
Je një plak  
I rrudhur, barbar.  
I palodhur vjen  
Nga rruga pa mbarim.  
Në krahë, shekuj mban.

Mjerim i mijëvjeçarit të ri  
Në ballin e njeriut shkruar,  
Që ditën kur linde  
Të pagëzuan “dritëshuar”.

Mjerim i mijëvjeçarit të ri,  
Plak rrudhanjak,  
Brazda rrudhash, kudo përhap.  
Të hirta, mavri,  
Të kuqe, blu, gri...  
Dritën e diellit, shteron  
Me skelete të ardhmen piketon.

## **OXHAKU I BOTËS TË FTOH**

Që të ngrohesh more bir  
Ngrehu në mëngjes pa gdhirë,  
Merr një sharrë e një sëpatë  
Dhe ngjitu malit lart.  
Mos kërkto të kthehesh mbrapa,  
Po të zuri shiu a vapa.  
Mos u lodh duke i prerë,  
Nga mali kush t'i bjerë?  
Mos kërkto rrugën e lehtë  
Matu me shejtanin vetë.  
Oxhaku i botës të ftoh  
Vetëm zjarri yt të ngroh.



## **PRANVERA IME**

E bukur erdhe prapë pranvera ime,  
Mbretëresha e gjithë mrekullive,  
Magjia e fladit, luleve, dashurive  
Që rendin plot vegime,  
Mes kaltërsive, pafundësive,  
Kurrë s'ke mbarim,  
E vetmja mikja ime.

E bukur erdhe prapë, pranvera ime.  
Do të pi verë e do të derdh lot  
Në krahët e tu magjiplotë.  
Do të qesh, do të qaj me ngazëllime,  
E brengën, moshën, realitetin e ftohtë  
Pa mëshirë do t'i mbys  
Mes dallgësh me shkumëzime.

E bukur erdhe prapë, pranvera ime,  
Ngarkuar me lule, flutura, bilbila  
Dallëndyshe që ngrenë folenë me kashtë  
Do t'i shkarkoj të gjitha,  
Do të hap dyer e dritare,  
E do t'i fus brenda,  
A mund t'i lë jashtë?

Kur bilbili të këndojë për mua,  
Dritaren nuk do ta mbyll prapë.  
Këngën e tij pranverore  
Këtë vit do ta këndojmë bashkë,  
Se pranvera nuk njeh moshë  
Magjishëm troket në çdo portë.

## KUSH E NJEH NUSEN TËNË

Kush e njeh nusen tënë,  
Del me yje vjen me hënë.  
Ç'bën kështu moj grykëzënë  
Burrëzinë ku e ke lënë?  
Kush e lan, kush për të ngrënë?  
Të kërkon derë më derë  
Me kandil e me fener.

Çitjanet s'i lidhe kurrë,  
E hoqe fare ushkur,  
Bufkë kuqeja flamur.  
Xhupi i zi të palos gjirin  
Si palët e trëndafilin,  
Llamburin si bukure  
Ku këtu e ku atje,  
Shpirtin shejtanit ia dhe.  
Burrat s'janë në mersele,<sup>1</sup>  
Të kërkojnë natën me pishë,  
Që të dalësh me këmishë.  
Me lajka ç'i molloise  
Kurrë qejfin nuk ua prishe.

---

<sup>1</sup> S'janë në vete, iu ka ikur mendja.

Qejfin si t'ua prish e shkreta?  
Më mbulojnë porsì bleta.  
Unë kam cipë në faqe.  
S'janë burra dosido  
Janë burra me mustaqe.

## NËNË MË JE LIGËSHTUAR

Atje lart në Llogora  
Ç'u shkëput pisha e ra,  
U sëmurë Behareja  
Behare Gjolekeja,  
Nëna ime e mira,  
Sorkadhja lart në Çikë  
Si aktore bukuritë,  
Shpirt e zemër e floringjtë.

Pesë vjet edhe ca muaj  
Nënë ç'më je ligështuar,  
T'u prenë fuqitë e kënga  
Moj zë ëmbël thëllëza.

Çelnin lule, ndriste hëna  
Atje ku të shkelte këmba,  
Fjalë ngrohta, fjalëmbra  
Rrezet e diellit për ty  
Paqshëm derdhnin mirësi.

Nëna ime je sëmurë  
Se unë t'u largova shumë,  
Larg-larg në atë udhë  
Kaptuar fusha e male,  
Mbytur në një det me halle.

O kurbet kërma,  
Më ndave përjetë nga nëna,  
Iu tha shpirti, iu plak zemra,  
Iu plak zemra e malluar,  
Se fëmijët iu larguan  
E sëmurë për ta po vuan.

Shpirti seç më ka dalldisur,  
Vetëm në një botë të krisur,  
Më është çjerrë e më është grisur,  
Se nënën kam të mërzhitur,  
Është sëmurë e është venitur.

Po të përgjërohem nënë:  
Mos më ik' e mos më lër!  
Mos më lër o yll e hënë!  
Dua veç me ty të rri  
Të të puth të ngrohtin gjë,  
Të loz e qesh porsi fëmi,  
Të të puth gjirin e ngrohtë,  
Të të fshij të hidhurin lot,  
Buzën e shpirtit të të puth  
Në gjirin tim të të fus,  
Të këndojmë lehtë-lehtë  
Ashtu bukur plot lezet,  
Këngët tona shtruar-shtruar  
Me zërat e kombinuar.  
Por avash-avash se s'ke medet,  
Je sëmurë e ke siklet.

## **ATA SY I DUA**

Ata sy i dua  
Kur lozin me mua,  
Dhe kur janë të qeshur,  
Dhe kur janë të vrenjtur  
Strukur nën vetull,  
Prapë ata i dua.

Ata sy i dua  
Siç i do një mike  
Me zemër besnike  
Si relikte antike.

Ata sy i dua  
Siç i do një femër  
Kur lotojnë si krua  
Dhe kërkajnë një emër.

## NË RRUGË TË PAFUNDME

Në rrugë të pafundme shkretëtirë  
Në pafundësi, endem,  
Vetëtima, bubullima,  
Rënkime, përgjërime,  
Mbi mua derdhen.

Të eci, të eci, Marathonomak  
Në netët pa hënë, në zheg e në vapë,  
Këmbëzbathur, mbi gërhalat  
E gurëve të djallit, të gjakosem,  
Në humbëtirat e deteve të humbas.  
Mes ulërimave të grisura të sirenave  
Të shurdhohem.  
Zëri të më fiket,  
Të mos flas.



Të rend, të rend, të rend,  
Me shpejtësinë e erës së shkalluar,  
Me flokët e mpira  
Shpupuritur, lëshuar.  
Në udhëkryqe të pleksura  
Pa fenerë, dëshpëruar.  
Arma e shpresës  
Diku larg, larg, ngujuar.

Buzë të thara, pa një grimcë gëzim  
Në zjarrin e dhimbjes, po shuhet shpirti im.

## **MBI QERPIKË TË DASHURUAR**

Puthje do të derdh pa hesap  
Mbi qerpikë të dashuruar,  
Lules sime mbi parmak  
Diell i paperënduar.

Me puthje, puthjet e mia  
Porsi vesa do të lag,  
Vetëm ty, jo ç'ke përçark,  
Se nga vapa kam merak,  
Mos më vyshkesh, e nuk çel prapë.

Lule moj lulja me erë  
Je për mua mrekullia,  
Kur të fryjë edhe të biesh,  
Do të ngroh në krahët e mi.

Më dehu kjo bukuri,  
Për mua nuk ka më dy,  
Se dhe kryebukuritë  
Nuk ngjasojnë me një të dytë.

Qenien time ke pushtuar  
Do të vdes i mrekulluar.

## TË KËRCEJ NJË TANGO

Të kërcëj një tango  
Në supet e tua,  
Lehtë-lehtë mbi taka  
Të të them të dua.

Dhe duke kërcyer  
Flokët të harlisen.  
Dy buzët që digjen  
Si padashur ngjiten.

Si ngjalë rrotulluar  
Gjoks e bel shtrënguar,  
Malli përpëlitet  
Në këmbë e në duar.

Do ta shuaj mallin  
Të dalë e ku të dalë,  
Melodi e lehtë  
Na fton në parajsë.

Tangoja ime e shtrenjtë  
Deri në agim  
Pentagrame këngësh  
Që nuk kanë mbarim.

## PËR VITIN E RI

Për vitin e ri  
Të bëhemi dy,  
Tek oxhaku i lartë  
Të bëhemi bashkë  
O shpirt i kristaltë.

Të bëhemi tok  
Pa miq e pa shokë,  
Se frika më tremb  
E dhimbja më dhemb  
O dhuratë e shtrenjtë.

Sytë e tu të kaltër,  
Pjellë dashurie,  
Dhe yjet i ndezin,  
Dhe në tokë zbresin  
Flakë lumturie.

Në gjunjë do të ulem  
Të puth ato duar,  
Të puth ata gjinj  
Të nxehtë si thëngjij,  
Se jam i malluar.

Ngrohtë mbi sixhade,  
Të thurur nga nëna,  
Gotat t'i trokasim,  
Me ngadalë të flasim,  
Se na dëgjon hëna.

Dashuri dhe verë  
Dhe buzët bashkuar,  
Viti i ri ylber  
Na troket në derë  
Dhe na thotë gëzuar.

## DASHURI E SHPIFUR

Një gjethe vjeshte  
Dashuria jonë,  
Shkëputur nga shoqet  
Lidhur me vargonj.  
Dashuri e shpifur  
E çjerrë, e grisur  
E verdhë e venitur.  
E vetme në rrugë  
Përpëlitet, vërtitet,  
Shkelmuar, helmuar  
Nga era lajkatare  
E pabesisë.  
Dalë nga xhepat  
E ligësisë,  
Të shpirtit tënd.  
Kërmill i mbledhur  
Djalli vetë,  
Me bisht të përdredhur.